

## **PERMBAJTJA**

### **1- Të përgjithshme**

Emri i Partisë, orientimi politik dhe qëllimi i aktivitetit, vendndodhja e selisë qendrore, simboli, flamuri, vula, mënyra e funksionimit, shtrirja organizative, veprimi.

### **2- Anëtarësia**

Kriteret e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrat, përfundimi i anëtarësisë.

### **3- Strukturat qendrore të " Fryma e Re Demokratike"**

Kuvendi dhe kompetencat e tij, Asambleja Kombëtare dhe kompetencat e saj, Kryesia e FRD dhe kompetencat e saj, Kryetari, Nënkyetari, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari Koordinativ, Sekretariati, Grupi Parlamentar, bordet, komisionet e përhershme.

Administrata

### **4- Strukturat lokale të " Fryma e Re Demokratike"**

Dega e Partisë në rreth dhe organet drejtuese, Konferenca, Kryesia, Kryetari, Nënkyetari, Sekretari, bordet, aparati administrativ i Degës; Degë të FRD jashtë vendit; N/Degët në njësitë bashkiake, bashkitë e nivelit të dytë, komunave dhe organet drejtuese të tyre - Kryesia, Kryetari, nënkyetari, Sekretari, Konferenca; Seksionet e FRD sipas territoreve të qendrave të votimit dhe organet drejtuese të tyre -Kryetari, Sekretari, Kryesia.

### **5- Organizatat ndihmëse të "Fryma e Re Demokratike"**

Grupimi Rinor, Forumi i Gruas.

### **5- Dispozita të fundit**

Përparësitë, rishikimi dhe hyrja në fuqi e statutit.

## **TE PERGJITHSHME**

### **Neni 1**

Partia mban emrin " FRYMA E RE DEMOKRATIKE " (FRD)

Orientimi politik dhe qëllimi i aktivitetit

### **Neni 2**

Fryma e Re Demokratike është parti e qendrës së djathtë që ka për qëllim konkurimin politik përmes zgjedhjeve, duke respektuar lirinë, barazinë dhe drejtësinë në një garë politike. Ajo ka për qëllim të materializojë në interes të vendit forcimin e identitetit dhe dinjitetit kombëtar, ruajtjen dhe forcimin e autoritetit të shtetit të së drejtës, lirinë e mendimit dhe dinjitetin e individit, të drejtat dhe detyrat themelore të tyre, shenjtërinë e pronës private dhe rregullimin e pronës shtetërore, zhvillimin e iniciativës së lirë dhe barazinë e secilit në këtë proces, tregun e lirë dhe konkurrencën e ndershme si rruga e vetme e zhvillimit të vendit, drejtësinë shoqërore, ruajtjen e natyrës dhe ambjentit, garantimin e autonomisë në veprimtarinë e autoriteteve lokale, zhvillimin e sporteve, arteve dhe ruajtjen e kulturës kombëtare.

Selia qendrore

### **Neni 3**

Fryma e Re Demokratike (FRD) e ka selinë e saj qendrore në Kryeqytetin e vendit, TIRANE.

Simboli

### **Neni 4**

Simboli i Partisë "Fryma e Re Demokratike" përbëhet nga geramat "FRD" me ngjyrë të bardhë në një fushë blu, në raporte të përcaktuara dhe të pandryshueshme.

Flamuri

#### **Neni 5**

Flamuri i Fryma e Re Demokratike është me ngjyrë blu, në qendër të të cilit është vendosur simboli FRD me ngjyrë të bardhë, në raporte të përcaktuara dhe të pandryshueshme.

Vula

#### **Neni 6**

Vula e FRD ka formë të rrumbullakët, ku shkruhet në formë rrethi FRYMA E RE DEMOKRATIKE, në qendër të së cilës vendoset simboli "FRD". Vula mund të përdoret vetëm nga organet qendrore të FRD dhe nga administrata ekzekutive e selisë qendrore sipas rregullave të përcaktuara. Degët e FRD përdorin të njëjtin model vule, duke shtuar në pjesën e poshtme emrin e degës përkatëse.

Shtrirja organizative

#### **Neni 7**

Fryma e Re Demokratike është grupim politik vullnetar i qytetarëve të mbledhur në strukturat e saj, të organizuara në bazë të ndarjes territoriale dhe të shtrira në funksion të hartës elektorale të vendit.

Mënyra e funksionimit

#### **Neni 8**

Mënyra e funksionimit të Fryma e Re Demokratike bazohet në demokracinë e brendshme të saj, e shprehur nëpërmjet votës së anëtarësisë. FRD ka në themel të veprimtarisë së saj parimin:

***- "Një anëtar një votë",***

***-institucionalizimi i mendimit ndryshe dhe***

***-mandatet e kufizuara të drejtuesve partiakë në qendër e në bazë.***

Rregullat e funksionimit demokratik të Partisë, në zbatim të parimeve të mësipërme dhe sipas këtij Statuti, përcaktohen me akte të nxjerra nga organet drejtuese dhe qendrore të saj.

Veprimi

### **Neni 9**

Veprimi i Fryma e Re Demokratike për arritjen e qëllimeve të saj bazohet në veprimtarinë e anëtarëve të saj, të strukturave ekzekutive të organeve qendrore e lokale kur qeveris e vetme ose në koalicion. Në funksion të realizimit të qëllimeve të saj Fryma e Re Demokratike përdor manifestime e protesta, tubime të hapura e të mbyllura, mediat private e publike, si dhe çdo formë tjetër të ligjshme. Fryma e Re Demokratike zhvillon veprimtari politike dhe jashtë territorit të vendit, në përputhje me ligjet e vendeve përkatëse.

## ***ANETARËSIA E FRD***

Procedurat e pranimit dhe përfundimit të antarësisë në FRD

### **Neni 10**

Në FRD mund të anëtarësohet çdo qytetar që pranon Programin dhe Statutin dhe ka plotësuar formularin e antarësisimit pranë zyrave qendrore ose lokale të FRD ose duke aplikuar on-line. Moshë më e re për t'u pranuar në FRD është 16-vjeç.

Anëtarësia në Parti përfundon kur anëtari ndërron jetë ose largohet me kërkesën e tij.

Të drejtat e anëtarit të FRD

### **Neni 11**

Anëtari ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, të propozojë kandidatura për organet vendimmarrëse dhe ekzekutive të Partisë.

Anëtari ka të drejtë të shprehë lirish mendimin e tij për veprimtarinë e partisë dhe të marrë pjesë në çdo forum e aktivitet në përputhje me rregullat e vendosura nga Statuti dhe Rregullorja e Brendshme.

Detyrat e anëtarit të FRD

### **Neni 12**

Anëtari ka për detyrë të marrë pjesë në aktivitetet politike dhe elektorale të Partisë; të paguajë kuotizacionin; të respektojë rregullat e përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Brendshme.

## ***STRUKTURAT QENDRORE TE FRD***

Organizimi i përgjithshëm i FRD

### **Neni 13**

Organet qendrore të Fryma e Re Demokratike janë Kuvendi, Asambleja Kombëtare, Kryesia e Partisë, Kryetari i Partisë, Nënkryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari Koordinativ, Sekretariati, Grupi Parlamentar, bordet, komisionet e përhershme.

Kuvendi i FRD

### **Neni 14**

Kuvendi është organi më i lartë i Partisë me mandat 4(katër)vjeçar.

Kuvendi përbëhet nga anëtarët e Asamblesë Kombëtare, anëtarët e Bordeve Qendrore, dhe, nga një numër i kufizuar të zgjedhurish nga Konferencat e degëve, sipas kritereve të përcaktuara nga Kryesia Qendrore por, në asnjë rast, ky numër nuk mund të jetë më i vogël se numri i anëtarëve të Asamblesë si pasojë e funksioneve të ndryshme.

Mandati i anëtarit të Kuvendit Kombëtar i zgjedhur me votim është katër vjeçar, ndërsa mandati i anëtarit si pasojë e funksioneve, përfundon me përfundimin e mandatit përkatës.

Kuvendi mbledhet minimumi një herë në dy vjet, me vendim të Asamblesë Kombëtare, pas propozimit të Kryetarit të Partisë ose të Kryesisë së Partisë.

Kuvendi mund të mblihdhet në sesione të jashtëzakonshme, sipas procedurës së mësipërme ose me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të tij.

Vendimet e Kuvendit merren me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve, me votim të fshehtë ose të hapur, sipas rasteve të përcaktuara në Statut.

## Kompetencat e Kuvendit

### **Neni 15**

Kuvendi është organi i vetëm që vendos për programin dhe linjën politike të Partisë, miraton Statutin dhe zgjedh Asamblesën Kombëtare.

Kuvendi shqyrton propozime të ndryshme për çështje që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e Partisë të ardhura nga Kryetari, Asambleja, Kryesia e Partisë, kryesitë e degëve dhe nga çdo anëtar i Kuvendit.

## Asambleja Kombëtare e FRD

### **Neni 16**

Asambleja Kombëtare drejton veprimtarinë e Partisë në periudhën ndërmjet dy Kuvendeve, në përputhje me programin, statutin dhe vendimet e Kuvendit. Asambleja ka mandat 4(katër)vjeçar.

Asambleja Kombëtare përbëhet nga Kryetari i Asamblesë, Kryesia Qendrore e Partisë, deputetët e Kuvendit, ministrat, kryetarët e Këshillave të Qarqeve, të Bashkive Qendër-Qarku, kryetarët e degëve, prefektët, kryetari i Grupimit Rinor, Kryetari i Forumit të Gruas dhe, nga anëtarë të zgjedhur sipas përfaqësimit territorial të vendosur nga Kryesia Qendrore.

Asambleja Kombëtare mblihdhet të paktën dy herë në vit nga Kryetari ose me kërkesën e 30% anëtarëve të tij.

Vendimet e Asamblesë Kombëtare merren me shumicë të thjeshtë votash, por në asnjë rast pa kuorumin e nevojshëm të gjysmës së anëtarëve të saj. Votimi bëhet i hapur, me përjashtim të rasteve kur Statuti përcakton ndryshe.

## Kompetencat e Asambleja Kombëtare

### **Neni 17**

Asambleja Kombëtare merr, në periudhën ndërmjet dy Kuvendeve, vendime që në këtë Statut nuk janë përcaktuar ekskluzivisht kompetenca të Kuvendit.

Asambleja Kombëtare

-Zgjedh nga rradhët e veta Kryetarin e Konventës dhe anëtarët e Kryesisë Qendrore që nuk janë në rradhët e kësaj të fundit si pasojë e funksioneve të përcaktuara në Statut;

-Nënkryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Koordinativ;

-Sekretarët e bordeve që përbëjnë Sekretariatit e Partisë;

-Miraton përbërjen e komisioneve të përhershme të statutit, rregullores dhe apelit;

-Miraton listat emërore të kandidatëve për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë dhe kandidaturat elektorale me të cilat do të përfaqësohet Partia në zgjedhjet vendore.

Procedurat për zgjedhjet dhe miratimet e mësipërme përcaktohen në Statut dhe ne Rregulloren e Brendshme të Partisë.

## Kryesia Qendrore

### **Neni 18**

Kryesia e Partisë përbëhet nga Kryetari i Partisë, Kryetari i Asamblesë, Nënkryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari Koordinativ, Sekretariati dhe nga anëtarët e tjerë të zgjedhur sipas procedurës së përcaktuar në Statut.

Anëtarë të Kryesisë janë automatikisht ish-Presidenti i Republikës, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, nëse ata i përkasin Fryma e Re Demokratike. Anëtar i Kryesisë është dhe kryetari i grupit parlamentar të FRD.

## Kompetencat e Kryesisë

### **Neni 19**

Kryesia e Partisë është organi që merret me zbatimin e gjithë vendimeve të marra nga Kuvendi dhe Asambleja Kombëtare.

Kryesia miraton kandidaturat për Kryetarin e Partisë dhe nis procedurat për zgjedhjen e Kryetarit të Partisë sipas parimit “Një anëtar, një votë”, i propozon për miratim Asamblesë kandidaturat për Kryetar të Partisë.

Kryesia e Partisë miraton kandidaturat e ardhura nga Degët dhe Nëndegët për kryetarë, sekretarë dhe nënkryetarë të tyre.

Kryesia e Partisë i propozon Asamblesë Kombëtare kandidaturat për anëtarë të Asamblesë Kombëtare, miraton komisionin e mandateve, të votimeve dhe sekretarinë e Asamblesë.

Kryesia e Partisë i propozon Asamblesë Kombëtare datën dhe rendin e ditës së mbledhjes së Kuvendit.

Kryesia emëron sekretarin e Degës nga propozimet e ardhura nga kryesia e degës.

Kryesia miraton strukturën organike të Partisë dhe strukturën e pagave.

#### Kryetari i FRD

#### **Neni 20**

Kryetari i Partisë zgjidhet nga anëtarësia e Partisë sipas parimit "Një anëtar, një votë", por jo më shumë se dy mandate në këtë post.

Kryetari i Partisë përfaqëson Partinë në të gjitha aktivitetet politike dhe shoqërore brenda dhe jashtë vendit.

Kryetari thërret Kuvendin Kombëtar, Asamblenë Kombëtare dhe Kryesinë e Partisë.

Kryetari i propozon Asamblesë Kombëtare, me propozim të Kryesisë, kandidaturat për nënkryetar partie dhe Sekretar të Përgjithshëm.

Kryetari emëron Zëdhënësin e Partisë.

Kryetari emëron, me miratimin e Kryesisë, sekretarët e Bordeve.



## Nënkryetari i FRD

### **Neni 21**

Nënkryetari i Fryma e Re Demokratike zgjidhet nga Asambleja Kombëtare, në përputhje me nenin 14 dhe 16 të këtij Statuti, por jo më shumë se dy mandate në këtë post.

Nënkryetari ushtron kompetencat në zbatim të delegimit të detyrave nga Kryetari dhe Kryesia.

Me autorizim të Kryetarit, në rastet e mungesave të gjata dhe kur e shikon ai të nevojshme, njëri nga nënkryetarët zëvendëson Kryetarin.

## Sekretari i Përgjithshëm i FRD

### **Neni 22**

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë është përgjegjës për funksionimin organizativ dhe administrativ të Partisë në qendër dhe në të gjitha strukturat e vendit.

Në përmbushje të detyrave të tij, ai ndihmohet drejtpërdrejt nga Sekretari Koordinativ dhe Sekretariati i Partisë.

Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga Asambleja Kombëtare, në përputhje me nenin 14 dhe 16 të këtij Statuti, por jo më shumë se dy mandate.

## Sekretari Koordinativ i FRD

### **Neni 23**

Sekretari Koordinativ është në varësi direkte nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm. Ai merret me koordinimin e gjithë veprimtarive në të gjitha hallkat përbërëse të strukturës së Partisë.

Sekretari Koordinativ zgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja Kombëtare, në përputhje me nenin 14 dhe nenin 16 të këtij Statuti dhe nuk mund të qëndrojë në këtë pozicion më shumë se dy mandate.

## Sekretariati

### **Neni 24**

Sekretariati përbëhet nga sekretarët e bordeve, të cilët kanë varësi direkte nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm. Ata janë përgjegjës për mirëfunksionimin e bordeve qendrore të Partisë dhe raportojnë periodikisht për punën e kryer tek Kryetari i Partisë dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Sekretarët e bordeve zgjidhen dhe shkarkohen nga Asambleja Kombëtare, sipas nenit 14 dhe 16 të këtij Statuti.

## Bordet

### **Neni 25**

Bordet janë pjesë të rëndësishme të strukturës së Partisë dhe merren me hartimin e politikave dhe strategjive të ndryshme.

Ndarja, përcaktimi, detyrat dhe mënyra e funksionimit të tyre, rregullohen nëpërmjet Rregullores së Brendshme të Partisë, të miratuar nga Kryesia.

Anëtarët e bordeve emërohen nga Kryesia me propozim të Kryetarit të Partisë dhe degëve në rrethe, sipas nenit 17 të këtij Statuti.

## Grupi Parlamentar

### **Neni 26**

Grupi Parlamentar i FRD përbëhet nga deputetët e saj në Kuvendin e Shqipërisë. Ai përfaqëson dhe mbron në Kuvend programin dhe interesat e Partisë. Grupi Parlamentar zhvillon aktivitetin e tij në Kuvend nëpërmjet një rregullorje të miratuar nga vetë deputetët.

## ***KOMISIONET E PERHERSHME***

Komisioni i Statutit dhe i Rregullores së Brendëshme

### **Neni 27**

Komisioni i Statutit dhe i Rregullores së Brendëshme harton draftin e statutit dhe të rregullores, dhe paraqet ndryshime e përmirësime të tyre kur e vlerëson të nevojshme.

Komisioni mbledh propozimet e ardhura nga cdo strukturë e Partisë për ndryshime në Statut dhe Rregullore.

Propozimet i paraqiten Kryesisë, e cila pas miratimit, ia dërgon Kuvendit kur bëhet fjalë për Statutin dhe Asamblesë kur bëhet fjalë për Rregulloren e Brendëshme.

#### Komisioni i Apelimit

##### **Neni 28**

Komisioni i Apelimit merr në shqyrtim dhe vendos për ankesat që i drejtohen dhe që lidhen me masa të ndryshme ndaj cdo anëtari të FRD, në cilindo nivel a funksion.

Vendimet e komisionit janë të paapelueshme.

#### Administrata Qendrore

##### **Neni 29**

Selia qendrore e FRD ka administratën e saj që funksionon sipas një rregulloreje të veçantë, hartuar nga Komisioni i Rregullores dhe miratuar nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë.

#### ***STRUKTURAT LOKALE TE FRD***

##### **Neni 30**

Strukturat lokale të FRD funksionojnë mbi bazën e njësive territoriale administrative. Strukturat organizative të FRD janë: degët e FRD, të cilat janë të shtrira mbi bazën e ndarjes territoriale të rrethit; nëndegët, të cilat janë të shtrira mbi bazën e ndarjes territoriale të njësisë bashkiake, dhe të komunave; seksionet, të cilat përputhen me kufizimet territoriale të një qendre votimi.

## Dega e FRD

### **Neni 31**

Dega e FRD e ushtron aktivitetin e saj mbi bazën e ndarjes territoriale të rrethit, nga i cili merr edhe emërtimin respektiv. Organet drejtuese të degës janë: Konferenca, Kryetari, Kryesia, Nënkryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari Koordinativ, Bordi i Financës.

Aktiviteti i Degës ndihmohet dhe nga administrata e Degës.

## Konferenca e Degës së FRD

### **Neni 32**

Konferenca e Degës përbëhet nga kryesitë e nëndegëve, deputetë dhe kryetarët e njësive vendore të zonës përkatëse elektorale dhe administrative, si dhe një numër i caktuar anëtarësh të përzgjedhur nga seksionet, numër, i cili përcaktohet nga Kryesia Qendrore e Partisë, në proporcion të drejtë me numrin e seksioneve, por që në asnjë rast nuk do të jetë më i vogël se numri i anëtarëve të Konferencës që janë të tillë si pasojë e funksioneve. Lista zyrtare e anëtarëve të Konferencës publikohet nga Kryetari dhe Sekretari i Degës, jo më vonë se dy muaj kalendarikë nga data e mbajtjes së punimeve të saj.

Mandati i Konferencës së Degës është 4(katër)vjeçar.

## Kompetencat e Konferencës së Degës

### **Neni 33**

Konferenca e Degës zgjedh me votim të fshehtë, në konkurim të jo më pak se dy kandidaturave për çdo anëtar të kryesisë, atë pjesë të anëtarëve të kryesisë së Degës që nuk është e tillë si pasojë e funksioneve, pas propozimeve të ardhura nga baza e Partisë në nëndegë dhe të shpërndara në proporcion të drejtë me numrin e njësive.

Konferenca e Degës zgjedh me votim të fshehtë, ndërmjet një numuri jo më pak se dyfishi i kandidaturave që i takon asaj dege, anëtarët e Kuvendit, pas propozimeve të bazës së Partisë nëpër seksione.

## Kryesia e Degës së FRD

### **Neni 34**

Kryesia e Degës së FRD përbëhet nga Kryetari, Nënkryetari, Sekretari i Degës, kryetarët e nëndegëve, deputetë të Kuvendit me banim në zonë, kryetarët e njësive vendore si pasojë e funksioneve dhe, nga anëtarët e zgjedhur nga konferenca e Degës, në zbatim të procedurës së përcaktuar në nenin 35 të këtij Statuti. Ajo ka një mandat 4(katër)vjeçar.

Kryesia e Degës vlerëson dhe miraton, pas propozimeve të ardhura nga nëndegët, kandidaturat që do të përfaqësojnë Partinë në zgjedhjet politike dhe lokale dhe i përcjell për vendim në Kryesinë Qendrore, si dhe Nënkryetarin.

Kryesia e Degës është përgjegjëse para Kryesisë Qendrore për organizimin dhe aktivitetet e Degës gjatë veprimtarive politike dhe fushatave elektorale.

## Organet drejtuese të Degës së FRD

### **Neni 35**

Organet drejtuese të Degës së FRD janë : Kryetari, Nënkryetari, Sekretari dhe Sekretariati.

Kryetari i Degës zgjidhet në përputhje me parimin "Një anëtar, një votë". Mandati i Kryetarit të Degës është 4(katër)vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë në këtë post. Kryetari i Degës është njëkohësisht anëtar i Kryesisë Qendrore, dhe i Asamblesë Kombëtare.

Nënkryetari i Degës zgjidhet me propozim të Kryetarit të Degës, pas miratimit nga Kryesia Qendrore, nga jo më pak se dy kandidatura, me votim të fshehtë ose me konsensus, nga Kryesia e Degës. Nënkryetari i Degës është automatikisht, si pasojë e funksionit, anëtar i Konferencës së Degës.

Sekretari i Degës emërohet nga Kryesia Qendrore e Partisë. Sekretari i Degës ka për detyrë të ndjek zbatimin e vendimeve të organeve eprore të Partisë në qendër dhe në rrethin përkatës, duke raportuar në mënyrë periodike përpara Kryesisë së Degës.

## Financat dhe Bordi Financiar i Degës

### **Neni 36**

Burimet financiare të strukturave të Degës së Partisë rrjedhin nga grantet e Kryesisë Qendrore, kuotizacioni i anëtarësisë dhe donacionet nga subjekte të tjera, sipas ligjit të partive politike.

Burimet financiare administrohen nga bordi i financave të Degës, i cili duhet të konsultohet paraprakisht për çdo transaksion, me Kryetarin dhe Sekretarin e Degës.

Bordi i Financave përbëhet nga 3(tre) anëtarë, të propozuar nga Kryetari i Degës dhe të miratuar nga Kryesia e Degës. Kryetari i Degës emëron, nga anëtarët e Bordit, kryetarin e bordit, pas miratimit të marrë më parë nga sekretari i bordit të financës në Kryesinë Qendrore.

## Administrata e Degës

### **Neni 37**

Dega e Partisë ka administratën e saj, e cila përbëhet dhe funksionon sipas Rregullores së Brendëshme të Partisë.

Personeli i aparatit emërohet nga Kryetari i Degës.

## Degë të FRD jashtë vendit

### **Neni 38**

Degë të FRD formohen dhe të funksionojnë edhe jashtë territorit të Shqipërisë, me miratim të Kryesisë Qendrore të FRD.

Anëtarë të Partisë të Degës jashtë territorit të Shqipërisë janë qytetarët shqiptarë që banojnë në vendin përkatës.

Dega e FRD jashtë territorit të Shqipërisë është e strukturuar dhe funksionon sipas një rregulloreje të hartuar nga vetë dega përkatëse dhe e miratuar në Kryesinë Qendrore të Partisë.

## **NENDEGA E FRD**

### **Neni 39**

Nëdega e FRD është njësia më e rëndësishme në bazën e strukturës së Partisë, e cila formohet ose shkrihet me vendim të Kryesisë Qendrore të Partisë dhe e ushtron aktivitetin e saj në bazë të ndarjes territoriale sipas qeverisjes vendore (minibashki dhe komuna). Brenda nëndegëve janë të përfshira seksionet përkatëse të Partisë.

Organet e Nëndegës janë Konferenca, Kryetari, Kryesia, Sekretari, Nënkryetari.

-Konferenca e Nëndegës përbëhet nga kryesia e nëndegës, deputetë dhe të zgjedhur vendor të zonës përkatëse elektorale dhe administrative, si dhe një numër i caktuar anëtarësh të zgjedhur nga anëtarësia e seksioneve. Mandati i konferencës së nëndegës është 4(katër) vjeçar.

-Kryesia e Nëndegës së FRD drejton strukturat nën juridiksionin e saj në periudhën ndërmjet dy konferencave dhe ka mandat 4 (katër) vjeçar. Kryesia e nëndegës përbëhet, si pasojë e funksioneve nga Kryetari, nënkryetari, sekretari, deputetë të Kuvendit me banim në zonë, të zgjedhur të pushtetit vendor dhe, nga anëtarët që zgjidhen nga Konferenca e Nëndegës.

-Kryetari i Nëndegës së FRD, i cili zgjidhet sipas parimit "Një anëtar, një votë" nga anëtarësia përkatëse. Zgjedhjet me këtë rast organizohen nga Kryesia e Degës. Mandati i Kryetarit të nëndegës është 4(katër)vjeçar dhe nuk mund të përsëritet më shumë se një herë në këtë post.

-Nënkryetari i Nëndegës zgjidhet me propozim të Kryetarit të Nëndegës, pas miratimit nga Kryesia e Degës, në jo më pak se dy kandidatura, me votim të fshehtë ose me konsensus nga Kryesia e Nëndegës. Kandidaturat duhet të jenë domosdoshmërisht nga rradhët e Kryesisë së Nëndegës.

- Sekretari i Nëndegës ka detyrë të zbatojë vendimet e organeve qendrore dhe të kryesisë së Nëndegës. Sekretari i Nëndegës është përgjegjës për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të aktivitetit të Nëndegës.

### Seksioni i FRD

### **Neni 40**

Seksioni është njësia më e vogël strukturore e FRD dhe ushtron aktivitetin mbi bazën e ndarjes territoriale sipas qendrës së votimit. Seksionet krijohen, shkrihen ose ndahen, sipas faktorëve dhe kushteve specifike, me vendim të kryesisë së degës përkatëse.

Seksioni i FRD ka kryetarin, sekretarin, kryesinë dhe anëtarët e tij.

-Kryetari i seksionit të FRD zgjidhet në përputhje me parimin "Një anëtar, një votë", nga anëtarësia e seksionit.

-Sekretari i seksionit të FRD zgjidhet nga anëtarët e seksionit me votim të fshehtë, ndërmjet jo më pak se dy kandidaturave të propozuara nga anëtarët e seksionit.

-Kryesia e seksionit të FRD përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë, kur anëtarësia është deri 9 (nëntë) persona dhe jo më shumë se 5(pesë) anëtarë, kur anëtarësia është më shumë se nëntë persona.

-Kryetari, sekretari dhe kryesia e seksionit të FRD zgjidhet një herë në katër vjet dhe nuk mund të zgjidhet më shumë se dy mandate në këto pozicione.

#### Organizatat ndihmëse të FRD

##### **Neni 41**

Organizatat ndihmëse të FRD janë Grupimi Rinor dhe Forumi i Gruas. Qëllimi i aktivitetit të tyre është përhapja dhe zbatimi i programit të FRD tek grupet e interesit që përfaqësojnë.

Këto organizata funksionojnë sipas statuteve të miratuara nga organet e tyre drejtuese.

#### ***DISPOZITA E FUNDIT***

##### Aktet nënstatutore

##### **Neni 41**

Asambleja Kombëtare dhe Kryesia e FRD hartojnë akte nënstatutore në zbatim të këtij Statuti, të cilat janë detyrimisht të zbatueshme nga instancat e ndryshme të FRD. Këto akte konsistojnë në rregullore, vendime, udhëzime dhe urdhëresa, të cilat, në asnjë rast nuk mund të bien në kundërshtim me nenet e këtij Statuti.



## Ndryshimi i Statutit

### **Neni 42**

Të drejtën për ndryshimin e Statutit e ka Kuvendi i Partisë me një vendimmarrje të detyrueshme të shumicës absolute të tij.

## Hyrja në fuqi

### **Neni 43**

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit në Komisionin Nismëtar të FRD.

Pas miratimit në Komisionin Nismëtar Statuti mund të përmirësohet, të plotësohet ose të përsojë ndryshime.

Statusi i përmirësuar, i plotësuar apo i ndryshuar, hyn në fuqi pasi miratohet nga Kuvendi i FRD.

**Grupi nismëtar i FRD**

**Kryetari**

**GAZMEND OKETA**